



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal  
Mbledhja nr. 62  
Prishtinë, me 07 shkurt 2024, në orën: 11.00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Valon Ramadani, Isak Shabani, Fidan Jilta, Tinka Kurti, Nijazi Isaku, Fitim Haziri, Besim Muzaqi dhe Besnik Tahiri.

Mungoi: Agim Veliu dhe Mergim Lushtaku.

Në mbledhje morën pjesë: zv. Kryeministri, Besnik Bislimi, Tea Blakaj, Jeton Mehmeti, Kryetar i KPM-së, OSBE, KDI, D+, AMPEK, RTK, Kallxo.com, Ekonomia online, Indeksonline.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Valon Ramadani, kryetar i komisionit, me këtë:

**Rend dite:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave;**
- 4. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**  
Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

### 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave;

**Valon Ramadani**, njoftoi anëtarët e komisionit, se në bazë të Nenit 74, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit, është ngarkuar komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal për shqyrtimin në parim të Projektligjit nr.08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Meqë, propozues i Projektligjit nr.08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave, është Qeveria e Republikës së Kosovës, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Zv. Kryeministri **z. Besnik Bislimi** ishte i ftuar në mbledhje për ta prezantuar projektligjin.

Kryetari i komisionit ia kaloi fjalën,

**Besnik Bislimi**, me projektligj shfuqizohet Ligji për KPM, vlen të theksohet se për draftimin e projektligjit bazë është marrë direktiva e BE-së, projektligji ka 60 nene dhe plotësim - ndryshimi i tij po bëhet me qëllim të harmonizimit të tij me direktivën AVMS, kjo është një kërkesë ndër vite e Komisionit European e cekur në raportet për Kosovën.

Qëllimi i projektligjit është fuqizimi i KPM dhe ngritja e përgjegjësisë së KPM-së për sigurimin dhe mbikëqyrjen e transmetimit të programeve cilësore edukative, informative, gjithnjë në dobi të interesit të përgjithshëm. Në projektligj KPM merr përsipër përgjegjësinë e procesit të kalimit të transmetimit në sistemin digjital.

Gjithashtu, me projektligj bëhet transpozimi i direktivës AVMS-së dhe kontribuon në përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së. Televizionet dhe platformat e ndryshme me përmbajtje audiovizuale e kanë audiencën e përbashkët, në këtë kontekst është e pashmangshme që të sigurojmë një mjedis konkurrues që bazohet në rregullat e qarta, por edhe të gjithë pjesëmarrësve i garanton mundësi të barabarta, pra, kushte të njëjta për secilin ofrues të shërbimeve mediale, kushte që caktohen nga KPM si një institucion i pavarur kushtetues dhe larg nga çdo ndikim politik.

Direktiva në fjalë dhe projektligji aplikohen mbi shërbime që prodhojnë programe e të cilat synojnë informim, edukim, argëtim.

Shërbimet audiovizuale të cilat janë të ndara në përmbajtje nga aktiviteti bazë i dhënësit të shërbimit si dhe ato që ndahen përmes një platforme të veçantë bënë domenin e KPM-së.

Direktiva e BE-së nënkupton një obligim që të njëjtat të transpozohen nga të gjitha shtetet anëtare. Jemi në dijeni që vite më parë ka pasur dëme të shkaktuara nga mungesa e rregullave që kërkojnë transparencë mbi pronësinë e mediave, tani kjo do të përcaktohet me ligjin në fjalë, andaj me qëllim të pluralizmit dhe fuqizimit të lirisë së shprehjes dhe promovimit medial, duke iu shmangur në të njëjtën kohë konfliktit të interesit është me rëndësi që qytetarët apo shfrytëzuesit të kenë qasje në informacion lidhur me pronarët e mediave.

**Valon Ramadani**, ia kaloi fjalën anëtarëve të komisionit për debat.

**Fitim Haziri**, lidhur me informatat e fundit se nuk është mbajtur konsultim publik në procedurat derisa projektligji është draftuar, pyetja e tij ishte se, a janë ftuar Këshilli i mediave të shkruara dhe grupeve të tjera të interesit në konsultime publike.

**Tea Blakaj, ZKM**, u përgjigj, meqë projektligji është në procedura të draftimit që nga viti 2021 konsiderojmë se i njëjti ka kaluar të gjitha format e konsultimit publik nga ZKM.

**Isak Shabani**, duke pasur parasysh faktin se për projektligjin në fjalë janë ngritur shqetësime nga grupet e interesit dhe shoqëria civile, se në draftin e hartuar ka hapësirë për keqinterpretime e të cilat po e cungojnë lirinë e mediave, ai propozoi që projektligji të procedohet në Komisionin e Venecias me qëllim të riparimit për interesin gjithëpërfshirës, sipas tij projektligji duhet të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese.

**Besnik Bislimi**, u përgjigj, përkundrazi me projektligj promovohet liria e mediave dhe synimi është integrimi institucional medial.

**Besim Muzaqi**, tha se, direktiva e BE-se e vitit 2010 ka pasur ndryshime dhe plotësime me direktivën e vitit 2018 dhe e njëjta i është përshtatur zhvillimeve të kohës, aktualisht Qeveria me projektligj i përshtatet zhvillimeve të lajmit audiovizuel. Ndërsa, sa i përket propozimeve për dërgimin e projektligjit në Komisionin e Venecias është paragjykim dhe konsiderohet qëndrim apriori.

**Besnik Tahiri**, pyetja e tij ishte, rritja e numrit të anëtarëve të KPM-së nga 7 në 11 dhe zgjatja e mandatit në 4 vite, përmes projektligjit pushteti po tenton ti merr nën kontroll mediat online, cilat janë arsyet që këto organizata mediale të regjistruara si OJQ detyrohen, sipas projektligjit, të kthehen në biznese të regjistruara.

**Besnik Bislimi**, me projektligj do të vendoset rregullativa për funksionimin e mediave online e cila deri tani ka munguar, është mendim i gabuar se Qeveria po tenton ti merr nën kontroll mediat online.

Sa i përket regjistrimit të mediave online në biznese, kjo duhet të bëhet sepse mediat online plasojnë kontent dhe qëllimi i kontentit është realizimi i të hyrave, në këtë kontekst ato duhet të regjistrohen po qe se gjenerojnë të hyra, ndërsa kur është fjala për rritjen e numrit të anëtarëve ka rrjedh si rezultat i diskutimeve në publik e mundësia për rizgjedhje edhe për një mandat është shmangie nga kufizimi për ushtrimin e vetëm një mandati.

**Fidan Jilta**, projektligji ka një rëndësi të veçantë, vërejtjet, propozimet mund të i japim në fazën e amendamentimit të projektligjit.

**Tinka Kurti**, tha se me projektligj promovohet liria e mediave, pronësia e mediave, garantohet mbrojtja e të drejtave të fëmijëve, andaj mbi këtë bazë është i domosdoshëm miratimi i tij.

**Nijazi Isaku**, Projektligji ka dallim me ligjin në fuqi, sepse me projektligj po vendoset rregull medial.

**Valon Ramadani**, pas diskutimeve, propozoi që ligji të hudhet në votim për miratim në parim.

**Konstatim:** Komisioni me 6 vota “Për”, asnjë kundër dhe asnjë abstenim miratoi Projektligjin dhe nxori këtë:

### **R e k o m a n d i m**

1. Të miratohet në parim Projektligji nr.08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave.
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputeti, Valon Ramadani, Kryetar i Komisionit.

### **Arsyetim**

Në bazë të nenit 74 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional e ka shqyrtuar projektligjin në parim, para leximit të parë në mbledhje plenare, dhe Kuvendit ia paraqet raportin me rekomandime për miratim në parim.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit nr.08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 71 të Rregullores së Kuvendit dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij në parim.

Mbledhja përfundoi në orën: 12:20.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i Komisionit.**

**Valon Ramadani,**  
**Kryetar i Komisionit**

---